



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 10/07/2019 Nr.020-767
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendim Nr. 54/2019 për miratimin e ndryshimit të vendimit Nr 463-1667 të datës 10.05.2011 për këmbim të pronës së paluajtshme të komunës me pronën private

I miratuar më datë: 28/06/2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02/07/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si dhe nenit 3 të Kontratës mbi shkëmbimin e patundshmërive të lidhur me datë 08 gusht 2011, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Gazmend Muhaxheri, gradonačelnik Opštine Peć Islam Husaj, predsedavajući Skupštine opštine Peć	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS,	
Preko:	ZA Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u,	R. Kurim Bajolli
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 10.07.2019. Br.020-767
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Peć	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Peć,	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 54/2019 za usvajanje izmene Odluke br. 463-1667 od dana, 10.05.2011 za razmenu nepokretne imovine sa privatnom imovinom
Usvojena dana, 28.06.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 02.07.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja akta kao i člana 3 Ugovora o razmeni nekretnina skopljenih dana, 08.avgusta 2011. godine navedenog akta procenjuje da je opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa **zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi.**

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVË
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA

HYRËSE-ULAZNA-NË KOMUNË
REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIC OF KOSOVO
BEVRE E KOSOVËS VLAKA KOSOVO GOVERNMENT OFFICE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracija
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date

02-07-2019

Forma organizatë	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-01-	410-767		

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numiër:463-01/81828, datë: 28.Qershor 2019.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të neneve 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës Komunale Ligji nr.06/L-092, si dhe neneve 14 al.1 pika k), dhe 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 06-3595 dt.29.06.2012, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për ndryshimin e vendimit të KK Pejë nr.Lnr.463-1667 të dt.10.05.2011 lidhur me këmbimin e pronës Komunale me pronën private të Shkelzen Hadërgjonaj nga Peja, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 28. Qershor 2019, muar:

V E N D I M

Nr. 54/2019

MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KK PEJË I NR.463-1667 DT.10.05.2011 PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për ndryshimin e vendimit të KK Pejë nr.Lnr.463-1667 të dt.10.05.2011 lidhur me këmbimin e pronës Komunale me pronën private të Shkelzen Hadërgjonaj nga Peja më të cilin vendim është aprovuar propozimi i DUMM dhe i Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës Komunale e cila gjëndet në ngastrën kadatrale 4741/21 në sipërfaqe prej 1105 m2 ZK Pejë me 20 banesa me nga 70 m2 në total prej 1400 m2 pronë private e z. Shkelzen Hadërgjonaj nga Peja me çrast këto banesa të kalojnë në emër të Komunës dhe të shfrytëzohen për kompenzimin e pronave private të cilat Komuna do ti shpronsoj për hapjen e rrugëve publike në BT "Kristal" dhe "7 Shtatori" në Pejë.

II. Ndryshimi i vendimit të cekur më lartë ka të bëjë:

1. Me ndryshimin e sipërfaqeve të banesave në vend të banesave me mesatare prej 70 m2 do të jenë me mesatare të sipërfaqeve prej 77 m2 që do të thotë se për njëzet banesa do të shtohet sipërfaqja prej 140 m2 më shumë.
2. Banesat do të shfrytëzohen për kompenzimin e pronave private të cilat Komuna do ti shpronsoj apo do ti këmbej për interes publik me qëllim të realizimit të Planeve Rregulluese Urbane të Komunës së Pejës të miratuara nga Kuvendi Komunal Pejë, si dhe për ndonjë rast ekstrem të strehimit familjar, dhe jo vetëm për kompenzimin për shpronsimet për hapjen e rrugëve publike në BT "Kristal" dhe "7 Shtatori" në Pejë siç ka qenë në Vendimin e ndryshuar I.nr.463-1667 të dt.10.05.2011.


III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Çështje Pronësoro - Juridike.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT,
Dr. Islam Husaj

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1. MAPL-së.
- 1x1. Kryetarit të Komunës.
- 1x1. DÇPJ-ke.
- 1x1. Arkivë.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / O

SKUPŠTINA OPŠTINE PEÇ

I.Broj:463-01/81828, dana: 28. Juna 2019 god.

Na osnovu odredbi članova 11 i 12 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosovo i na osnovu članova 24 i 25 Zakona o davanju na korišćenje i razmeni opštinske imovine br. 06/L-092, kao i člana 36 Statuta Opštine Peć, 01.br.09-8103 od 29.09.2008, posle razmatranja predloga Gradonačelnika Opštine za prethodno usvajanje izmene odluke SO Peć I.br.463-1667 od 10.05.2011. u vezi sa razmenom opštinske imovine za imovinu Shkelzen Hadergjonaj iz Peći, popreporuci Komiteta za Politiku i Finansije, Skupština Opštine Peć je na sednici održanoj dana 28.Juna 2019, donela je:

ODLUKU

Br.54/2019

**O USVAJANJU IZMENE ODLUKE SO PEĆ I.BR.463-1667 OD 10.05.2011. O RAZMENI
OPŠTINSKIH NEKRETNINA ZA NEKRETNINU PRIVATNOG LICA**

I. **USVAJA SE** predlog Gradonačelnika Opštine za usvajanje izmene odluke SO Peć I.br.463-1667 od 10.05.2011.u vezi sa razmenom opštinske imovine za imovinu fizičkog lica Shkelzen Hadergjonaj iz Peći u vezi predloga DUZS-a i Gradonačelnika za razmenu imovine koja se nalazi na kat.parc. 4741/21 sa površinom od 1105 m2 KZ Peć sa 20 stanova sa po 70m2, ukupno 1400 m2, privatna svojina Shkelzen Hadergjonaja da bi nekretnina prešla na ime Opštine i da se koristi za nadoknadu privatnih imovina u slučajevima eksproprijacije za otvaranje javnog puta u naselju Kristal i 7. Septembar u Peći.

II. Navedena izmena se tiče sledećeg:

1) Izmjena prosečne površine stanova umesto 70 m2 je 77 m2, što znači da će se za 20 stanova dodati još 140 m2 površine.

2) Stanovi će se koristiti za nadoknadu imovina na kojima Opština vrši eksproprijaciju i razmenu imovine u javnom interesu sa ciljem ostvarivanja Regulativnog Urbanističkog Plana Opštine Peć, usvojenog od Skupštine Opštine Peć, ne samo za nadoknadu za otvaranje puteva u javnom interesu u naseljima Kristal i 7. septembar u Peći, kako je predviđeno izmenjenom odlukom I.Br.463-1667 od 10.05.2011, nego i za koji ekstreman slučaj porodičnog smestaja.

III. Za primenu ove odluke zadužen je Gradonačelnik Opštine preko Direktorata za Pravno-Imovinska Pitanja.

IV. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon upisivanja u kancelariji protokola MALV kao i 7 dana po objavljivanju na službenoj Web stranici Opštine Peć.

PRESEDAVAJUĆI SKUPŠTINE

Dr.Islam Husaj

Odluku dostaviti:

1x1 MALS.

1x1. Gradonačelniku Opštine.

1x1. DIPP.

1x1. Arhivi.

HYRE SE-MALVACIJA REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministricтво Локалне Самоуправа и Администрације Ministry of Local Government Administration			
Case	02-07-2019		
Date			
Num. organizativi	Nr. i Lendës	Shtojca	Vlera
- 41 -	020	767	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

Në bazë të nenit 5. paragrafi 1. pika b) dhe nenit 14. paragrafi 1. të Ligjit 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28. date: 04.Qershor 2008) dhe nenit 11.paragrafi 1. të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 10.Maj 2011, pas shqyrtimit të propozimit të DUMM. dhe propozimit të Kryetarit të komunës për këmbim të pronës komunale me 20 banesa pronë private të z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, njëzërit muar këtë

V E N D I M


MIRATOHET Propozimi i DUMM. dhe Kryetarit të komunës së Pejës, për këmbim të pronës komunale ngast.kad.nr.4741/21 në sipërfaqe prej: 00.11,05 ha, me 20 Banesa me nga 70 m2.në total 1400 m2 (sipërfaqe e shfrytëzuar), pronë private e z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, të objektit afaristo - banesor që do të ndërtohet në ngast.kad. nr.4740/2,4740/3,4741/20 dhe 5755/54, me sygjerim që këto banesa që do të jenë objekt këmbimi, pas këmbimit të regjistrohen si pronë komunale me destinim: për kompenzimin e prionave që duhet shpronësu për hapjen e rrugëve publike sipas Planit Rregullativ Urban për B.T."Kristal" dhe "7 Shtatori" ku përfshihet edhe kompleksi - lagja Fidanishte Pejë.

Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK.Pejë.

Vendimi ti dërgohet: DUMM.-sit, z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 10.Maj 2011.

I.Numër: 463 – 1667
Pejë, date:10.Maj 2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESIA
Dr. Arbëresha Ajdini Nallbani



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Uda - Government

MINISTRIA E MËDITSHMË DHE PLANIFIKIMIT BASHKËNGJERË MINISTARITVO SËRBIJË I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGENCIJA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611071-04741-21

Numeri i vendos / Broj Predmet / Case Reference Number: 86007
Data dhe koha e kështimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 04.07.2019 - 15:06
Komuna / Opština / Municipality: Pejë / Peë / Peje
Zona kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone: PEJE / PEË / PEJE
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Pejë / Peë / Peje

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Namri i njësisë kadastrale Broj kadastrarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vlaka ardhurë Unit Type	Lloji i pronës Vlasti inovine Property Type	Zona L/R G/S E/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar në datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71611071-04741-21	PAJTELLE / PARCELA / PARCELA	/ /	Urban	1105	Kerkesa nr.01-5-1/11 dt.14.02.2011		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivarske - adresa Resident - address	Kodi Postar Postanski Kod Postal Code	Hollësi të adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar në datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
GRADINA/KARABURAN/KRABRINA		GRADINA		

Printuar nga / Odsampano od / Printed by: Qendra Shërbimi / P-71611071-04741-21

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

A211011 SHFRYTEZIMET / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri / Broj / Number	Tip / Shprehendja / Vrsta / Korisçenja / Parcel Type / Of Use	Shprehendja aktuale / Parcela / Traktimi / Korisçenje / parcel / Parcel Current Use	Kualiteti / Klasa / Niveli / Klasa / Quality / Class	Shprehendja / M ² / Përfaqësia / M ² / Area
1	Take / Tërheq / Ombur / Zonime / other and	Jo / Përdore / Nepërdore / U përdoret /		185



B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat / Prava / Rights	Emri / Imer / Name	Nr. personal / Ident / broj / ID, No.	Vendbanimi / Preh / adrese / Resident	Kodi postar / Postar / shiki / Postal code	Hollësi / të e adresës / Përfundim / adresë / Address details	Pjesa e pronës / Dru / inovative / Share / quota	Përshkrimi / Ops / Description	Azhu / rru / rru / Azhu / rru / E-plated
Posedim individual / Individuale / Drzetim / Single possessor	P. SH. N. K. PEJË	EC10161822	PEJË / BEÇ / PEJË /			1/1	Kodës nr. 01-5-1/11 dt. 14.02.2011	



Kopje-Plani - Kopija Plana




P/R 1: 1:1000

Zona Kadastrale: PEJE
Kadastrska Zona: 2

Plani Kadast. Nr.: 6
Kadast. Plan Br.: 6

POSEDUESI: _____
POSEDNIK: P.S.H. K.F. PEJE
BASHKËPOSEDUES NË PJESË IDEALE: _____
SUPOSEDNIK Æ IDEALNE DELOVIMA: _____




Nr. rendor i regjistrimit të takave: _____
Ref. broj spiska katastarskih takana: _____

Nr. i lëndës: 86007 19
Br. predmet: _____

Nr. i ngast/objek. Br. parcele/obj.	Kultura Kultura	Klasa Klasa	Kompleksi - vendi i parcelës Potes - zvano mesto	Sipërfaqja	Bashkëposedues në
				Povrsina	pjesë ideale
				m ²	Suposednik u idealne delovima
<u>474/21</u>				<u>1195</u>	

Kopje e planit bëhet besnike e origjinalit të vetë sipas gjendjes së fundit në Kadastr.
Da je ova kopija veran svome originalu prema postojnjem stanju u Katastru.
Funoi: _____
Uradio-la: _____ vit.
Pejë: 20.07.19 god.
Pec: _____



DREJTORI:
DIREKTOR:
M. Jela



KONTRATË MBI SHKËMBIMIN E PATUNDSHMËRIVE

E lidhur me dt.08 gusht 2011(dymijenjëmbëdhjetë) në mes të Komunës së Pejës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Pejë Dr. Ali Berisha në njërën anë, dhe Shkëlzen Hadërgjonaj nga Peja me nr. të leje së njoftimit 1006867932 , rr. Nato –së, banim kolektiv , në anën tjetër.

Neni 1

Lëndë e kësaj kontrate është këmbimi i pronës komunale ngastra kadastrale nr.4741/21 në sipërfaqe prej 00.11.05 ha ; me 20 banesa pronë private e z.Shkëlzen Hadërgjonaj nga Peja , të objektit afaristo –banesor që do të ndërtohet në ngastrën kad.nr.4740/2,4740/3, 4741/20 dhe 5755/54 , me sugjerim që këto banesa të jenë objekt këmbimi, pas këmbimit të regjistruhen si pronë komunale me destinim për kompensimin e pronave që duhet shpronësuar për hapjen e rrugëve publike sipas Planit Rregullues Urban për B.T.” Kristali” dhe “7 Shtatori “ dhe qëllimeve tjera komunale.

Neni 2

Banesat që janë objekt këmbimi do të ndërtohen në “**Godinën E**” sipas projektit ideor të ofruar – Qendra banesore ish Tregu i Gjelbër të investitorit Shkëlzen Hadërgjonaj dhe kushteve të lokacionit të lëshuara me datë 29.VII.2011 më numër 08-350-5393 me etazhitet B+P+6K. Gjithashtu në ngastrën kadastrale me numër 4741-21 lejohet ndërtimi i dy objekteve tjera “Godina C” (K.L. Datë 29.VII.2011 nr. 08-350-5395) dhe “Godina D” (K.L. Datë 29.VII.2011 nr. 08-350-5394) me etazhitet B+P+6K.

Neni 3

Banesat do të jenë me sipërfaqe prej : dy (2) 76m² deri dy(2) 78m² në kat , mesatarja do të jetë 77 m² për çka pajtohet investitori . Ky ndryshim i sipërfaqeve prej 70m² në mesataren 77m² bëhet për arsye: të zgjidhjes urbanistike të projektit për 20 banesa x 7 m² = 140 m² janë ma shumë se vendimi i miratuar me 10.Maj.2011 numër 01-463-1667. Për diferencën 140m² lëshohen kushtet e lokacionit me një etazhë ma lartë për çka është pajtuar edhe vetë investitori.

Neni 4

Hapësira Publike para ngastrës kadastrale nr.4741/21 që është objekt ndërrimi mbet hapësirë publike për shfrytëzim vetëm për parking për nevojat afariste të kompleksit shumë banesorë i kombinuar me gjelbërim të ulët.

Neni 5

Banesat që do të ndërtohen , e janë objekt ndërrimi lirohen nga pagesa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore.

Neni 6

Afati kohor i ndërtimit të banesave do të jetë 2 vite e gjysmë , duke llogaritur nga dita e marrjes së lejes së ndërtimit.

Neni 7

Kontraktuesit hekin dorë nga e drejta në rast të lindjes së kontestit lidhur me këmbimin e patundshmërive sipas çfarëdo baze, të njëjtin kontest do ta zgjedhin me marrëveshje.

Neni 8

Kontraktuesit garantojnë se në patundshmëritë e shkëmbyera nuk kanë kurrfarë ngarkesa, e nëse ngarkesat paraqiten në ndërkohë, kontraktuesit obligohen që të njëjtat ti evitojnë në barë të tyre.

Neni 9

Për shkëmbimin e pronave, e përshkruar si në nenin 1 të kësaj Kontrate, Kuvendi Komunal Pejë, e ka dhënë pëlqimin me **Vendimin nr :I-463- 1667 datë 10/05/2011**

Neni 10

Pronën e këmbyer Komuna e Pejës do ta shfrytëzojë për këmbimin e pronave që duhet shpronësua për hapjen e rrugëve publike sipas Planit Rregulluese Urban për B.T.” K kristali dhe “7 Shtatori “ ku përfshihet edhe lagja Fidanishte Pejë, dhe qëllimeve tjera komunale.

Neni 11

Kontraktuesit i lejojnë njëri tjetrit që të i shfrytëzojnë dhe të i marrin në posedim pronat e këmbjera (banesat kur të përfundon ndërtimi i kompleksit) dhe atë përmes Procesverbalit.

Neni 12

Kjo Kontratë është lidhur në 6 (gjashtë) kopje identike nga të cilat palët kontraktuese i marrin nga 2 (dy) kopje, gjersa një kopje i dërgohet Drejtorisë për kadastrë me qëllim të bërjes së ndryshimeve kadastrale sipas Kontratës mbi shkëmbimin.


PALËT KONTRAKTUESE:

Për KONTRAKTUESIN E PARË:




Dr. Ali Berisha
Kryetar i Komunës
Komuna e Pejës

Për KONTRAKTUESIN E DYTË:



Shkëlzen Hadërgjonaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 5. paragrafi 1. pika b) dhe nenit 14. paragrafi 1. të Ligjit 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28. date: 04.Qershor 2008) dhe nenit 11.paragrafi 1. të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 10.Maj 2011, pas shqyrtimit të propozimit të DUMM. dhe propozimit të Kryetarit të komunës për këmbim të pronës komunale me 20 banesa pronë private të z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, njëzërit muar këtë

V E N D I M


MIRATOHET Propozimi i DUMM. dhe Kryetarit të komunës së Pejës, për këmbim të pronës komunale ngast.kad.nr.4741/21 në sipërfaqe prej: 00.11,05 ha, me 20 Banesa me nga 70 m2.në total 1400 m2 (sipërfaqe e shfrytëzuar), pronë private e z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, të objektit afaristo - bancesor që do të ndërtohet në ngast.kad. nr.4740/2,4740/3,4741/20 dhe 5755/54, me sygjerim që këto banesa që do të jenë objekt këmbimi, pas këmbimit të regjistrohesh si pronë komunale me destinim: për kompenzimin e prionave që duhet shpronësu për hapjen e rrugëve publike sipas Planit Rregullativ Urban për B.T."Kristal" dhe "7 Shtatori" ku përfshihet edhe kompleksi - lagja Fidanishte Pejë.

Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK.Pejë.

Vendimi ti dërgohet: DUMM.-sit, z.Shkëlzen Hadërgjonaj, nga Peja, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 10.Maj 2011.

I.Numër: 463 – 1667
Pejë, date:10.Maj 2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË



K R Y E S U E S J A
Dr. Arberesha Ajdini Naibani